Ī3.4

# VATRA E RINIS

**Revistë për Fëmijë**

Tiranë, me 1 Gusht 1936

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ
ΑΡΧΕΙΟ ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΛΑ
Αρ. Εγγρ.: 1.1(13)

Shum i ndershem im ungj.

Ka pak dit qe mora letren t'uaj dhe prita keto dit qe te permblithnja lende rreth çeshtjes qe na intereson – per Kishen t'one. Hollesirat qe me jepni me kenaqin e me gezojne; ashtu duhet te jete domosdo: vendi i juaj esht ne kryesine, kete e pranon çdo ἀμερόληπτος. Me vjen çudi me kriterin e z. Naçi i cili mpron me ngulme thezen e tij se ju duhet te vini si Episkop, se tjetri (Kisi) si me i vjeter ka te drejten e kryesis dhe se juve si i panjohur ketu me ambientin nuk do te mundni t'u beni balle dallaveraave te kryesis. Keto jane arsyetimet e atij, qe nga ana tjater deklarohet mik i juaj dhe adhuronjes i cilesive; por me duket se ay i bje daulles me kot. Per fat te keq s'ka qene e mundur t'a shoh z. K. Kotta. Me z. Xhafer Ypi kam folur dhe esht nje nga perkrahesit me te pare; me tha se ka bere fjale dhe te L. M. T. Mbreti i cili, tha, ka mendim shum te mire per meritat t'uaja. Por natyrisht çeshtja do zgjidhet ne marreveshje me hierarhine kishetare dhe me kompetentet e tjera. Edhe Imzot Vissarioni esht mprojtes enthusiast i ardhjes s'uaj si Kryetar i Kishes. Te pakte duket se jane ata qe kundershtojne duke mprojtur Imzot Kr. Kisin. Dhe nuk dihet tani si do behet. Me duket se ne ~~.....~~ javet e fundit kjo çeshtje ka hyre ne nje faze pasive, esht lene d. m. th. ne heshtje, te pakten keshtu duket dhe shtyhet zgjidhja. Per kandidatin tjeter z. Kotoko flitet se e pranoj dhe

pritet te vije. Ju e dini si t'a mbani vehten tani. Duhet te behet nje zgjidhje e çeshtjes e rregullshme dhe me pelqim qe te mos kete pengime mbarevajtja e Kishes s'one.

Letren z. Naçi ja dhashe. Munt t'ju shkruaje perseri edhe ay.

Po ju dergoj edhe liste per pak libra. Natyrisht e le dhe ne gjykimin t'uaj pelqimin e tyre. Do te jete me mire qe te m'i dergoni me nonje udhetar — jo me poste — qofte drejt ketu ose ne Korçe ne axhenti-librashites Kristos Kotzias (grek ky), per te mos bere shpenzime.

Ime-shoqe dhe femija jane shendosh' e mire dhe ju puthin doren; s'pushojne se uruari per ardhjen t'uaj; femijet kerkojne t'u sillni ca kryqka t'Ajnorosit.

Ju puth doren
Nipi i juaj
Vasillaqi

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΑΚΗ ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ